

Në bazë të Programit për aktivitete në fushën e sportit dhe të rinjve në Qytetin e Shkupit, për vitin 2020 (Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit nr. 17/19 data 24 dhjetor 2019), kryetari i Qytetit të Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE
për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për financimin e programeve dhe
projekteve në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit
për vitin 2020

I

Për realizimin e nevojave publike në fushën e sportit, Qyteti i Shkupit shpall Thirrje publike për financimin programeve dhe projekteve në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2020.

Aktivitetet sportive, programet dhe manifestimet dhe mjetet financiare për realizimin e tyre, Qyteti i Shkupit i përcakton me program vjetor gjë me të cilën shprehet interesi dhe nevojat në këtë sferë.

Programet dhe projektet duhet të sigurojnë zhvillim, stimulim dhe prezantim të vlerave dhe arritjeve sportive në fushën e sportit në nivel të qytetit të Shkupit.

Mjetet për financimin e programeve dhe projekteve do të sigurohen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2020.

Në përputhje me dispozitat dhe kriteret ligjore për përcaktimin e programit për sport dhe për sigurimin e mjeteve për realizimin e tyre, si dhe mbi bazën e vlerësimeve për programet e realizuara në vitin 2019, Qyteti i Shkupit me Programin për aktivitetet nga fusha e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2020, me katër (4) pikat e mëposhtme të Programit, do të përkrahë:

1. MANIFESTIME SPORTIVE TRADICIONALE

Qyteti i Shkupit do t'i financojë evenimentet dhe manifestimet sportive tradicionale të karakterit lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim ruajtjen e kontinuitetit të këtyre manifestimeve për të cilat ka interes nga ana e qytetarëve dhe që janë në interes të zhvillimit të sportit në qytetin e Shkupit, me mjete nga Buxheti i Qytetit të Shkupit, të shpërndara organizatorit (Federata kombëtare sportive, anëtare e Federatës kombëtare sportive dhe subjekte të tjera sportive).

Vetë emri manifestime sportive tradicionale tregon se Qyteti i Shkupit do të financojë manifestime të cilat kanë një traditë të paktën pesë vjeçare dhe që kanë lënë gjurmë të thella në zhvillimin e sportit në qytetin e Shkupit.

2. MANIFESTIME ME INTERES TË VEÇANTË PËR QYTETIN E SHKUPIT

Në fushën e manifestimeve me interes të veçantë, Qyteti i Shkupit do t'i financojë programet, projektet dhe aktivitetet e të gjitha subjekteve të interesuara sportive të cilat do të dorëzojnë programe, projekte dhe aktivitete për organizimin e manifestimeve dhe evenimenteve sportive me interes të veçantë për Qytetin e Shkupit.

3. PËRKRAHJA E PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE TË ORGANIZATAVE TË TJERA SPORTIVE ME INTERES PËR QYTETIN E SHKUPIT

Qyteti i Shkupit do t'i financojë programet, projektet dhe aktivitetet për realizimin e programeve të veçanta për krijimin e kushteve për realizimin e aktiviteteve sportive të sportistëve amatorë, të nxënësve dhe të rinjve, me theks të veçantë në realizimin e aktiviteteve sportive dhe garave të nxënësve në shkollat e mesme në territorin e qytetit të Shkupit. Qyteti i Shkupit do t'i përkrahë edhe programet e ndjeshme gjinore, projektet, aktivitetet dhe manifestimet.

Qyteti i Shkupit do t'i përkrahë iniciativat dhe aktivitetet për zhvillim e disiplinave sportive që nuk janë të pranishme në Qytet dhe që zënë vend të rëndësishëm në manifestimet ndërkombëtare si dhe në jetën sportive në kryeqytetet dhe qendrat e mëdha urbane në botë.

Mundësimi i komunikimit më intensiv të sportistëve dhe shoqatave të tyre me sportistët nga qytetet e vëllazëruara, kryeqytetet dhe qendrat e mëdha urbane në rajon dhe në botë, me qëllim avancimin e bashkëpunimit të ndërsjellë.

Qyteti i Shkupit do t'i përkrahë edhe aktivitetet rekreative sportive të personave me nevoja të posaçme në territorin e qytetit të Shkupit.

4. PROGRAME DHE PROJEKTE PLOTËSUESE

Qyteti i Shkupit do t'i financojë programet, projektet, aktivitetet dhe manifestimet që nuk janë të përfshira me pozicionet e mëparshme të tre pikave të lartpërmendura, dhe të cilat me aktualitetin e tyre, atraktivitetin, rëndësinë dhe cilësinë e tyre, kontribuojnë për realizimin e qëllimeve programore në fushën e sportit të Qytetit të Shkupit për vitin 2020.

II

Programet dhe projektet e propozuara, aktivitetet programore dhe manifestimet, përveç arsytimit duhet të përmbajnë edhe propozim konstruksionin buxhetor, në të cilin do të theksohen mjetet që kërkohen nga Buxheti i Qytetit të Shkupit, si dhe mjetet e siguruara nga Agjencia për të Rinj dhe Sport e Republikës së Maqedonisë Veriore, të ardhurat e veta dhe mjete nga burime të tjera.

III

Përveç fushave të cituara, fletëparaqitjet e dorëzuara duhet të plotësojnë qëllimet dhe kriteret të cilat janë dhënë të bashkëngjitura në Thirrjen publike, që është shpallur në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

IV

Në procedurën për shpërndarjen e mjeteve buxhetore nga Programi për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2020, do të pranohen ato programe/projekte, aktivitete programore dhe manifestime që në bazë të kriterëve do të sigurojnë minimum 55 pikë.

V

Paraqitja në Thirrjen publike kryhet me dorëzimin e fletëparaqitjes së plotësuar (aplikimi). Aplikuesi, përveç fletëparaqitjes, në mënyrë të detyrueshme duhet të dorëzojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- aktvendim për regjistrim në regjistër dhe gjendjen vijuese për regjistrimin e veprimtarisë jo më të vjetër se gjashtë muaj, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë Veriore;
- vërtetim për xhiro llogari të hapur dhe aktive dhe
- në varësi të statusit të aplikuesit, të dorëzohet Vendim për kryerjen e veprimtarisë sport, të lëshuar nga Agjencia për të Rinj dhe Sport e Republikës së Maqedonisë Veriore.

VI

Të dhënat e nevojshme si dhe propozim programet dhe projektet, me konstruksionin financiar, duhet të dorëzohen në fletëparaqitje të veçantë e cila mund të merret nga Arkivi i Qytetit të Shkupit (baraka 16) ose të shkarkohet nga ueb-faqja zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Thirrja publike zgjat gjithsej **32 ditë**, nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Thirrja publike shpallet më **27.12.2019** dhe zgjat deri më **27.01.2020**.

Fletëparaqitjet duhet të dorëzohen pranë Qytetit të Shkupit, nëpërmjet postës në adresën: Bul. "Ilinden" numër 82, 1000 Shkup, ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka 16), më së voni deri më datën 27.01.2020 deri në orën 19:00 në ditën e fundit të përfundimit të Thirrjes publike, me emërtim **"Thirrje publike për shpërndarjen e mjeteve buxhetore për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2020"**.

Fletëparaqitjet dorëzohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, pa shënimin e subjektit i cili dorëzon fletëparaqitjen.

Fletëparaqitjet e parregullta të cilat nuk janë dorëzuar në mënyrën që kërkohet në tekstin e mësipërm, përkatësisht ato me të dhëna të paplota dhe dokumentacion të pakompletuar, si dhe ato që nuk do të dorëzohen në afatin e caktuar, nuk do të shqyrtohen.

Informacione plotësuese mund të merren në tel: 3297-238 dhe 3297-320.

QYTETI I SHKUPIT